



REPUBLIKA E KOSOVES · REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E VITISE - OPŠTINA VITINA



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

Miratimi Me Datën 01.07.2025			
Numri i Dokumentit	Numri i Aktit	Shprehja e Përbashkët	Vlera Vërtetuese
01-110/05-402			

Komuna e Vitisë
Opština Vitina
Municipality Viti/na

Kuvendi i Komunës së Vitisë, në bazë të nenit 12, shkronja d të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40 (Gazeta Zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr.28/2008), neni 4, paragrafi 1, dhe neni 5 paragrafi 1 i Ligjit me Nr.04/L-010 për Bashkëpunim Ndërkomunal, lidhur me neni 10, paragrafi 3 të Ligjit Nr.04/L-060 për Mbeturina, kërkesës nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal Nr. 020-259/4 e datës 29.05.2025, neni 36, paragrafi 36.2, shkronja d të Statutit të Komunës së Vitisë Nr.01-013/491, Kuvendi i Komunës së Vitisë, në mbledhjen e mbajtur më datën 30.06.2025 miraton këtë:

V E N D I M

për shfuqizimin e Vendimit Nr. 01-110/05-402, të datës 29.04.2025 për miratimin e Planit Ndërkomunal për Menaxhimin e Integruar të Mbeturinave për Komunën e Gjilanit, Kamenicës, Vitisë, Novobërdes, Parteshit, Kllokotit, Ranillugut, Ferizajt, Kaçanikut, Shtimes, Hanit të Elezit, Shtërpçës.

Neni 1

Me këtë, Kuvendi i Komunës së Vitisë miraton vendimin për shfuqizimin e Vendimit Nr. 01-110/05-402, të datës 29.04.2025, për miratimin e Planit Ndërkomunal për Menaxhimin e Integruar të Mbeturinave për Komunën e Gjilanit, Kamenicës, Vitisë, Novobërdes, Parteshit, Kllokotit, Ranillugut, Ferizajt, Kaçanikut, Shtimes, Hanit të Elezit

Neni 2

Shfuqizimi bëhet me kërkesën e Ministrisë për Administrim të Pushtetit Lokal me Nr. 020-259/4, e datës 29.05.2025

Neni 3

Mbikëqyrjen e realizimit të këtij vendimi do ta bëjë Komuna e Vitisë përmes Drejtorisë për Shërbime Publike dhe Emergjencë.

Neni 4

Ky vendim hynë në fuqi pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, konformë nenit 10, pika 6 të Ligjit për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave Nr. 08/L-284, (Gazeta Zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr.24/27, Dhjetor 2024, dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në gjuhën zyrtare në web faqe të Komunës së Vitisë.

Vendimi u dorëzohet:

1. Zyrës së Kryetarit;
2. Drejtorisë për Shërbime Publike...;
3. MAPL-së; dhe
4. Arkivit.

KUVENDI I KOMUNËS SË VITISË

KRYESUESI

Bekim Azizi

